



# MANUALI PËR VLERËSIMIN E KONTRATAVE PPP NË SHQIPËRI



Ky manual është përgatitur në kuadër të projektit “Strengthening capacities for the sustainable monitoring of public contracts”, pjesë e programit Matra 2024. Përmbajtja e këtij dokumenti reflekton pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin apo politikat zyrtare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri. Ambasada nuk mban përgjegjësi për përdorimin e informacionit të përfshirë në këtë manual.

## **Kolofon**

Titulli: Manuali për Vlerësimin e Kontratave PPP në Shqipëri.

Dr. Besa Ombashi

Botuar nga: Centre for Legal Empowerment (CLE), në bashkëpunim me Albanian Institutes for Research, në kuadër të projektit "Strengthening capacities for the sustainable monitoring of public contracts", pjesë e programit Matra 2024, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri.

© Besa Ombashi, 2025

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një bazë të dhënash të automatizuar, ose të bëhet publike, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë elektronik, mekanik, përmes shtypjesh, kopjesh, apo në çdo mënyrë tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të botuesve.

Përmbajtja e këtij dokumenti reflekton pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin apo politikat zyrtare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri. Ambasada nuk mban përgjegjësi për përdorimin e informacionit të përfshirë në këtë manual.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky manual ofron një udhëzues praktik për analizën dhe vlerësimin e kontratave të Partneritetit Publik-Privat (PPP) në Shqipëri.

Me shembuj praktikë dhe indikatorë të matshëm, manuali synon të fuqizojë monitorimin nga shoqëria civile dhe të promovojë llogaridhënien në menaxhimin e financave publike. Ai është një mjet i vlefshëm për të gjithë aktorët e interesuar, përfshirë studentët, gazetarët, akademikët, organizatat joqeveritare, administratën publike dhe sektorin privat, që duan të kuptojnë dhe të vlerësojnë realisht performancën e PPP-ve në Shqipëri.

Manuali identifikon 6 fusha kyçe për vlerësimin e kontratave PPP, të cilat ndihmojnë në analizën e efektivitetit dhe përputhshmërisë së tyre me interesin publik:

- ❖ *Risia dhe Zhvillimi*  
PPP-ja duhet të sjellë risi që nuk mund të arrihen përmes prokurimit publik tradicional.
- ❖ *Përputhshmëria Kontraktuale*  
Objektivat strategjikë duhet të lidhen qartë me shërbimet e ofruara dhe me strukturën e pagesave.
- ❖ *Qëndrueshmëria Mjedisore dhe Sociale*  
PPP-ja duhet të jetë në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG), duke respektuar ndikimin në mjedis dhe komunitet.
- ❖ *Menaxhimi i Riskut*  
Risku duhet të ndahet në mënyrë të drejtë dhe efektive midis sektorit publik dhe atij privat.
- ❖ *Dallimi nga Prokurimi Publik Tradicional*  
Fokusimi duhet të jetë tek rezultatet (outcomes), jo vetëm tek burimet (inputs).
- ❖ *Transparenca Financiare*  
Pagesat duhet të jenë të lidhura me performancën dhe të raportohen publikisht për të garantuar llogaridhënie.

Manuali përfshin një matricë vlerësimi që ndihmon në analizën sistematike të kontratave PPP përmes një kombinimi të vlerësimit sasior dhe cilësor. Kjo matricë përbëhet nga:

- a) Pyetje kyçe për secilën nga 6 fushat e vlerësimit.
- b) Vlerësim numerik nga 1 deri në 5, ku: 1 = shumë i dobët 5 = shumë i mirë
- c) Komentet cilësore, që shërbejnë për të dokumentuar arsyetimin pas vlerësimit dhe për të nxjerrë në pah kontekste specifike apo shqetësime të veçanta.

Kjo qasje e kombinuar ndihmon në krijimin e një pamjeje të balancuar mbi performancën e një PPP-je, duke lejuar krahasime ndërmjet projekteve dhe identifikimin e praktikave të mira apo të dobëta.

## RASTE PRAKTIKE NË SHQIPËRI

Manuali analizon kontrata PPP në katër sektorë kryesorë, duke nxjerrë mësim nga praktikat konkrete:

- Shëndetësi – Laboratorët | Mungesë inovacioni dhe lidhje e dobët mes pagesave dhe performancës.
- Energji | Nevojë për objektiva të qarta mjedisore dhe ndarje efektive të riskut.
- Transport | Pagesat duhet të lidhen me cilësinë e shërbimit, si p.sh. respektimi i orarit të autobusëve.
- Mjedis | Rëndësia e konsultimit publik dhe vlerësimit të ndikimit mjedisor.

### ❖ Referenca Ndërkombëtare

Manuali mbështetet në literaturë dhe udhëzime nga institucione ndërkombëtare

Kjo lidhje me praktikat më të mira globale siguron një qasje të standardizuar dhe të besueshme për vlerësimin e PPP-ve.

### ❖ Përfundim

Një PPP e suksesshme është ajo që:

- Sjell vlerë të shtuar për publikun;
- Ka strukturë të qartë kontraktuale;
- Siguron qëndrueshmëri sociale dhe mjedisore;
- Ndaj riskun në mënyrë të drejtë;
- Është transparente dhe e monitorueshme.

Në mungesë të këtyre elementeve, PPP mund të kthehet në një barrë fiskale për shtetin dhe qytetarët.

## HYRJE

Partneritetet Publike-Private (PPP) janë instrumente strategjike që bashkojnë burimet dhe ekspertizën e sektorit publik dhe privat për të ofruar shërbime dhe infrastrukturë më cilësore për qytetarët.

Në Shqipëri, ofrimi i shërbimeve publike dhe zhvillimi i infrastrukturës shpesh përballen me sfida lidhur me burimet dhe efikasitetin. PPP-të synojnë të rrisin efikasitetin, të përmirësojnë menaxhimin e riskut dhe të garantojnë transparencë dhe llogaridhënie ndaj publikut.

Sipas Raportit Vjetor 2023 të Ministrisë së Financave:

- Deri në vitin 2023, janë miratuar 230 kontrata PPP, nga të cilat 224 janë aktive.
- Pagesat buxhetore për kontratat PPP përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të të ardhurave tatimore.
- Në sektorin e transportit, projekte si Milot-Morinë, Rruga e Arbrit dhe Aeroporti i Kukësit kanë evidentuar sfida në lidhjen mes pagesave dhe performancës.

Vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare dhe evropiane theksojnë rëndësinë e menaxhimit të mirë të PPP-ve:

- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vlerëson se angazhimi i Shqipërisë në PPP përfaqëson 8–9.5% të PBB-së, më shumë se çdo vend tjetër në rajon, dhe paralajmëron për rreziqe fiskale si dhe nevojën për menaxhim më të mirë të riskut dhe transparencës.
- Bashkimi Evropian (BE) dhe auditimet e institucioneve vendore si Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) kanë theksuar se:
  - a) Shumë kontrata janë propozime të pakërkuara, gjë që rrit rrezikun e mungesës së konkurrencës dhe transparencës.
  - b) Është e nevojshme të përmirësohen kapacitetet institucionale për vlerësimin dhe menaxhimin e PPP-ve.

Vlerësimi i PPP-ve nuk është vetëm një çështje teorike, por ka implikime reale fiskale dhe sociale. Integrimi i të dhënave nga raportet zyrtare ndihmon në një analizë më të plotë dhe të besueshme.

Për të qenë të suksesshme, PPP-të duhet të plotësojnë disa kushte bazë dhe të përgjigjen disa pyetjeve paraprake, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e rrezikut, inovacionit, transparencës dhe efikasitetit të kontratës.

## Katër pyetjet kryesore për krijimin e një PPP

### 1. Çfarë?

- Cili është objektivi strategjik?
- Cili është niveli i kompleksitetit dhe i rrisë krahasuar me prokurimin publik?

### 2. Burimet e brendshme

- Çfarë burimesh ka enti publik?
- A janë të mjaftueshme për nivelin e shërbimit dhe risinë e kërkuar?

### 3. Kostot dhe efienca

- A duhet të përdoret PPP, apo të vazhdohet me prokurimin tradicional?
- A sjell PPP-ja efikasitet dhe vlerë të shtuar?

### 4. Roli i tregut

- Cili rrezik mbahet nga sektori privat?
- Cilat janë avantazhet e koncesionit ose formave të tjera PPP për të arritur rezultatet?

Këto pyetje janë të thjeshta, por thelbësore, për të kuptuar nëse është zgjedhur forma më e favorshme kontraktuale dhe nëse janë ndjekur hapat e duhur për krijimin e një PPP të suksesshme.

Ky manual i thjeshtuar shërben si udhëzues praktik për studentët, gazetarët, organizatat monitoruese dhe të gjithë aktorët e interesuar që duan të kenë informacion mbi partneritetet Publike-Private, një temë me rëndësi të lartë për publikun.

Nëpërmjet këtyre parametrave të paraqitur në formë të thjeshtuar, mund të vlerësojmë nëse kemi të bëjmë me një PPP të suksesshme, duke u bazuar në praktikat evropiane dhe në rastet konkrete shqiptare në sektorë si shëndetësia, mjedisi, energjia dhe transporti.

## RISI TEKNOLOGJIKE / METODOLOGJIKE

**Pyetja kryesore:** Çfarë risi sjell PPP-ja, që nuk do të arrihej me prokurim publik?

**Parim:** PPP justifikohet vetëm nëse ofron vlerë të shtuar për publikun përmes inovacionit teknologjik, menaxhimit më efikas dhe cilësisë më të lartë të shërbimit (Vecchi, 2021).

**Shembull praktik (Shqipëri):** PP-ja për laboratorët shëndetësorë u prezantua si një formë inovacioni. Megjithatë, sipas raportit të BIRN (2020), pajisjet e reja nuk sollën përmirësime të dukshme krahasuar me laboratorët ekzistues, duke ngritur pikëpyetje mbi vlerën reale të shtuar.

### Përfundim:

Nëse një PPP nuk sjell inovacion të matshëm — qoftë në teknologji, menaxhim apo cilësi të shërbimit — ajo rrezikon të:

- ❖ Mos ofrojë vlerë reale për qytetarin
- ❖ Kthehet në një barrë fiskale për buxhetin publik
- ❖ Shërbejë më shumë interesave kontraktuale sesa nevojave publike

Prandaj, justifikimi i PPP-së duhet të bazohet në evidencë konkrete që tregon përmirësime të qarta krahasuar me alternativat tradicionale të prokurimit.

### **TREGUES MONITORIMI:**

#### **Krahasimi i performancës para dhe pas PPP**

Analiza e treguesve si: kohë pritjeje, cilësia e analizave laboratorike, aksesueshmëria e shërbimit.

#### **Evidencë mbi përdorimin e teknologjive të reja**

Vlerësimi i përmirësimeve teknologjike të sjella nga PPP, si pajisje moderne, digjitalizim dhe automatizim.

#### **Anketa me pacientë dhe përdorues**

Mbledhja e mendimeve të qytetarëve mbi cilësinë, aksesin dhe kënaqësinë me shërbimin pas implementimit të PPP-së.

#### **Raporte të pavarura mbi cilësinë**

Përdorimi i vlerësimeve nga institucione të pavarura për të verifikuar objektivisht performancën e PPP-së.

### **LITERATURA KRYESORE:**

- Vecchi, V. (2021). Public-Private Partnerships in Health. Palgrave Macmillan.
- OECD (2020). Value for Money in PPPs. OECD Guidelines.
- IMF (2018). How to Ensure Value for Money in PPPs.

### **PËRPUTHSHMËRIA E KONTRATËS**

**Pyetja kryesore:** A lidhen qartë objektivat strategjikë me shërbimet dhe mekanizmat financiarë?

**Parim:** Sipas EPEC, çdo kontratë PPP duhet të ketë një logjikë të brendshme që lidh objektivat me shërbimet dhe pagesat.

**Shembull praktik (Kroaci):** Në një kontratë PPP për transportin urban, pagesat ndaj operatorit privat ishin të lidhura me cilësinë e shërbimit, konkretisht me **mbërritjen e autobusëve në orar në stacionet e caktuara**. Ky mekanizëm i thjeshtë, por efektiv, solli një **përmirësim të dukshëm në transportin publik**, duke rritur besueshmërinë e shërbimit dhe kënaqësinë e qytetarëve

**Përfundim:** Kur në një PPP nuk ka koherencë midis objektivave dhe pagesave, kontrata rrezikon të:

- ❖ Prodhojë kosto pa rezultat konkret
- ❖ Shpenzojë fonde publike pa përmirësim të dukshëm në shërbim
- ❖ Dështojë në arritjen e qëllimeve strategjike

Për këtë arsye, është thelbësore që:

- ❖ Objektivat të jenë të qarta dhe të matshme
- ❖ Pagesat të lidhen drejtpërdrejt me performancën dhe rezultatet (outcomes)
- ❖ Të ketë mekanizma penalizues për mospërbushje

## TREGUES MONITORIMI:

### Kornizë logjike (logframe)

Kontrata duhet të përmbajë objektiva të qarta, indikatorë të matshëm dhe rezultate të pritshme.

### Pagesat të lidhura me rezultate (outcomes)

Jo vetëm me burimet (inputs), por me performancën reale të shërbimit.

### Raporte të rregullta mbi arritjen e objektivave

Monitorimi i vazhdueshëm përmes dokumentacionit të performancës.

### Penalite për mos përmbushje

Nëse objektivat nuk përmbushen sipas kontratës, duhet të aplikohen penalite të qarta dhe të zbatueshme.

Kjo strukturë ndihmon në **minimizimin e riskut për publikun** dhe në **rritjen e transparencës**

**LITERATURA KRYESORE:**

- EPEC (2019). A Guide to the Statistical Treatment of PPPs.
- Yescombe, E. (2013). Public-Private Partnerships: Principles of Policy and Finance. Elsevier.
- World Bank (2017). Framework for Disclosure in PPPs.

**QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE DHE SOCIALE**

**Pyetja kryesore:** Si ndikon projekti tek mjedisi dhe shoqëria?

**Parim:** Një PPP e qëndrueshme duhet të jetë në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm SDG 11 Qytete dhe komunitete të qëndrueshme, SDG 13 Veprim kundër ndryshimeve klimatike dhe SDG 16 Paqe, drejtësi dhe institucione të forta, duke mos shkaktuar dëm mjedisor apo tension social por të kontribuojë në zhvillim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.(UN, 2015).

Shembull praktik (Evropë): PPP-të në projekte infrastrukturore janë përballur me protesta dhe bllokime, për shkak të mungesës së konsultimit me komunitetin lokal, duke dëmtuar besimin publik dhe zbatimin e projekteve.

**Përfundim:**

PPP nuk është vetëm kontratë ekonomike, por kontratë sociale që duhet të reflektojë interesin publik, të përfshijë komunitetin dhe të mbrojë mjedisin.

**TREGUES MONITORIMI:**

Për të garantuar që një PPP është në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe interesin publik, duhet të zbatohen mekanizma të qartë monitorimi:

❖ **Raport i ndikimit mjedisor i publikuar**

Dokumentim i detajuar mbi ndikimin e projektit në mjedis, i aksesueshëm për publikun.

❖ **Konsultime të dokumentuara me komunitetin**

Proces i hapur dhe i dokumentuar i përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit.

❖ **Numri i vendeve të punës të krijuara**

Evidencë mbi kontributin ekonomik dhe social të projektit në komunitet.

❖ **Auditim vjetor mbi ndikimin social dhe mjedisor**

Vlerësim i pavarur dhe periodik për të monitoruar përputhshmërinë me objektivat e kontratës dhe SDG-të.

Literatura kryesore:

- United Nations (2015). Sustainable Development Goals.
- OECD (2019). Green PPPs and Climate Change.
- Vecchi, V., Hellowell, M. (2018). Sustainability and PPPs

## MENAXHIMI I RISKUT

**Pyetja kryesore:** A është përcaktuar një sistem i qartë dhe i drejtë për shpërndarjen e riskut ndërmjet palëve kontraktuese?

**Parim:** Sipas **IMF** dhe **OECD**, suksesi i një PPP nuk varet vetëm nga struktura formale e kontratës, por nga **transferimi real dhe efektiv i riskut** tek partneri privat. **PPP-ja e suksesshme** është ajo ku risku menaxhohet dhe ndahet në mënyrë të drejtë, duke reflektuar kapacitetin e secilit palë për ta përballuar atë.

### Shembull Praktik – Shqipëri

Në disa kontrata PPP në sektorin e shëndetësisë dhe infrastrukturës, është vërejtur se:

- ❖ Risku financiar është mbajtur nga shteti,
- ❖ Ndërsa fitimet janë përfituar nga partneri privat,
- ❖ Pa mekanizma efektivë për ndarjen e drejtë të përgjegjësiave.

Ky model krijon një asimetri të rrezikshme, ku publiku përballon humbjet, ndërsa privati përfiton pa ekspozim real ndaj riskut — duke minuar parimin e partneritetit të barabartë.

**Përfundim:** PPP ku risku nuk ndahet drejt midis publikut dhe privatit kthehet në “privatizim fitimesh dhe socializmi i humbjeve”.

### TREGUES MONITORIMI:

Për të siguruar që risku në një PPP të menaxhohet në mënyrë efektive dhe transparente, autoriteti publik duhet të zbatojë këto mekanizma:

- ❖ **Risk regjistër i përditësuar**

Një regjistër i detajuar i riskut që përditësohet rregullisht gjatë ekzekutimit të kontratës.

- ❖ **Raporte tremujore mbi menaxhimin e riskut**

Dokumentim periodik mbi risqet e identifikuara, masat e marra dhe efektet e tyre.

❖ **Mekanizma për uljen e riskut për çdo kategori**

Për çdo risk të identifikuar duhet të ekzistojë një strategji konkrete për zbutjen e tij.

❖ **Krahasim risk–përfitim mes palëve**

Analizë e balancës midis riskut të marrë dhe përfitimeve të realizuara nga secila palë.

**LITERATURA KRYESORE:**

- IMF (2018). Public Investment Management Assessment (PIMA).
- OECD (2020). Managing Risks in PPPs.
- Yescombe, E. (2013). Public-Private Partnerships: Principles of Policy and Finance.

**DALLIMI NGA KONTRATAT E ZAKONSHME TË PROKURIMIT**

**Pyetja kryesore:** A siguron PPP-ja thjeshtim të procedurave dhe shmangie të burokracisë së tepërt?

**Parim:** PPP nuk matet me *input* (numri i mjekëve, pajisjeve), por me *output* dhe *outcome* (cilësia e shërbimit, kënaqësia e qytetarit).

**Shembull praktik: PPP për inceneratorët,** ku mungesa e transparencës dhe fokusimi në ndërtim (*input*) pa rezultate të qarta në menaxhimin e mbetjeve ka ngritur dyshime për vlerën e shtuar

**Përfundim:** PPP e sukseshme nuk kanë *input*-e dhe penalitete të vendosura për to por fokusin kryesor e kanë tek rezultatet e matshme, kjo i dallon nga një prokurimi publik.

**TREGUES MONITORIMI:**

**Vlerësimi i Performancës në PPP përmes KPI-ve**

Për të garantuar që një PPP sjell **vlerë të shtuar për publikun**, duhet të përdoren tregues të qartë dhe të matshëm të performancës (KPI), të fokusuar në **rezultate**, jo vetëm në burime.

**Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI)**

Duhet të fokusohen në rezultate konkrete si cilësia e shërbimit, aksesueshmëria, kënaqësia e përdoruesve dhe ndikimi social.

**Raporte mbi vlerësimin e qytetarëve**

Anketa dhe reagimi i strukturuar nga përdoruesit e shërbimit për të matur perceptimin dhe përvojën reale.

### **Krahasim me prokurimin publik të mëparshëm**

Analizë krahasuese për të kuptuar nëse PPP-ja ka sjellë përmirësim të dukshëm krahasuar me modelin tradicional.

### **LITERATURA KRYESORE:**

- World Bank (2017). Benchmarking Infrastructure PPP Procurement.
- OECD (2015). Principles for Public Procurement.

### **TRANSPARENCA E MEKANIZMIT TË PAGESAVE**

**Pyetja kryesore:** A është mekanizmi i pagesës i qartë, i drejtë dhe i lidhur me performancën?

**Parim:** Transparenca në pagesa përbën një instrument kyç për të parandaluar korrupsionin dhe abuzimet.

**Shembull praktik:** Në shumë PPP në rajon, pagesat u bënë pa lidhje me performancën, duke shkaktuar humbje për shtetin. – **PPP nën hetim nga SPAK (Shqipëri)**

Nga viti 2017 deri në 2024, janë paguar rreth **800 milionë euro për 12 kontrata PPP**, nga të cilat **6 janë nën hetim për shpërdorim fondesh**. Pagesat janë rritur pavarësisht mungesës së rezultateve të verifikueshme.

**Përfundim:** Për të siguruar që PPP-të sjellin vlerë reale për publikun, është thelbësore që:

#### **Pagesat të jenë të lidhura me performancën**

*Ato duhet të bazohen në rezultate të matshme dhe të verifikueshme, jo vetëm në përmbushjen formale të kontratës.*

---

#### **Pagesat të jenë të aksesueshme publikisht**

*Informacioni mbi pagesat, indikatorët e performancës dhe raportet e monitorimit duhet të publikohen rregullisht për të garantuar transparencë dhe besim publik.*

---

**TREGUES MONITORIMI:****Transparenca dhe Kontrolli Financiar në PPP**

Për të siguruar që pagesat në PPP janë të drejta dhe të lidhura me performancën, duhet të zbatohen këto mekanizma:

- **Raporte publike mbi pagesat**

Informacioni mbi pagesat duhet të publikohet rregullisht dhe të jetë i aksesueshëm për qytetarët dhe organizatat monitoruese.

- **Auditime të pavarura mbi lidhjen pagesa–performance**

Vlerësime të jashtme që analizojnë nëse pagesat janë bërë në përputhje me rezultatet e arritura.

- **Aplikim real i penaliteteve**

Në rast mospërbushjeje të objektivave, penaltetet e parashikuara në kontratë duhet të zbatohen pa përjashtim.

**LITERATURA KRYESORE:**

- EPEC (2018). PPP Contract Management Guidance.

- World Bank (2019). Transparency in PPPs.

- OECD (2018). Integrity in Public Procurement.

**PËRFUNDIME**

Një PPP e suksesshme është rezultat i një ekuilibri të drejtë midis interesit publik dhe atij privat. Ajo duhet të garantojë:

- ❖ **Risi dhe vlerë të shtuar** në krahasim me prokurimin tradicional.
- ❖ **Lidhje të qartë** mes objektivave strategjike, shërbimeve të kontratës dhe mekanizmave të pagesave, të mbështetur nga një sistem i qartë monitorimi të përmbushjes.
- ❖ **Qëndrueshmëri mjedisore dhe sociale** si pjesë e kontratës.
- ❖ **Menaxhim dhe shpërndarje të drejtë të riskut operacional**, me monitorim gjatë gjithë zbatimit të kontratës.

- ❖ **Fokus tek rezultatet (outcomes)** dhe jo tek inputet apo kushtet burokratike.
- ❖ **Transparencë dhe llogaridhënie** në çdo hap.

Nëse këto elemente nuk plotësohen, partneriteti publik-privat nuk arrin të krijojë vlerë të shtuar për shërbimin publik dhe për qytetarët, por shndërrohet në një barrë financiare për taksapaguesit. Sipas Vecchi (2021), **qëllimi kryesor i një PPP është të ofrojë risinë e shërbimeve, efikasitetin operacional dhe transparencën financiare**, duke ruajtur një balancë midis interesit publik dhe privat. Kur elementët kyç – si monitorimi i performancës, shpërndarja e riskut dhe lidhja e pagesave me rezultatin – mungojnë, kontrata humbet funksionin e saj strategjik dhe efektivitetin social (EPEC, 2019). Studimet empirike tregojnë se mungesa e këtyre mekanizmave çon shpesh në **rritje të kostove për qytetarët dhe abuzime të mundshme**, duke konfirmuar rëndësinë e një strukture të qartë kontraktuale dhe llogaridhënie transparente (Yescombe, 2018).

### MATRICA E VLERËSIMIT PËR PPP

Fusha	Pyetja Kryesore	Vlerësimi (1-5)	Koment
Risi/ Zhvillim	Çfarë risi sjell PPP-ja?		
Përputhshmëria e Kontratës	A lidhen objektivat me pagesat?		
Qëndrueshmëria	Ndikimi në mjedis dhe shoqëri?		
Menaxhimi i riskut	A ka shpërndarje të qartë të riskut?		
Transparenca	A janë pagesat transparente?		
Monitorimi	Ka pasur monitorim dhe respektim të afateve		

### TABELA PËR RASTIN E SHËNDETËSISË NË SHQIPËRI

Aspekti	Përshkrimi	Treguesit e Monitorimit	Mësimet e Nxjerra
Përputhshmëria kontraktuale	PPP për laboratorët duhet të lidhë pagesat me përmirësimin e shërbimeve laboratorike.	Numri i analizave të kryera, koha e përgjigjes, kënaqësia e pacientëve	Pagesat duhet të lidhen me performancën për të garantuar përmirësim të dukshëm.
Qëndrueshmëria mjedisore dhe sociale	Shërbimet laboratorike duhet të jenë të	Përqindja e pacientëve të mbuluar, raportet	PPP duhet të garantojë akses të barabartë dhe të

	aksesueshme dhe të sigurojnë trajtim të barabartë.	mbi aksesin në zonat rurale	mos krijojë pabarazi sociale.
Transparenca financiare	Pagesat për operatorët privatë duhet të jenë të qarta dhe të raportuara publikisht.	Raporte financiare, auditime të pavarura, publikimi i kontratës	Transparenca ndihmon në shmangien e abuzimeve dhe rrit besimin publik.

**TABELA PËR RASTIN E ENERGJISË NË SHQIPËRI**

<b>Aspekti</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Treguesit e Monitorimit</b>	<b>Mësimet e Nxjerra</b>
Qëndrueshmëria	PPP-të në energji duhet të kontribuojnë në burime të rinovueshme dhe reduktim të ndotjes.	Raporte mjedisore, përqindja e energjisë së gjelbër, ndikimi në CO2	Nevoja për objektiva të qarta mjedisore dhe matje të ndikimit.
Menaxhimi i Riskut	Risku i ndërtimit, operimit dhe tregut duhet të ndahet qartë mes palëve.	Regjistër risku, mekanizma kompensimi, analiza e ndarjes së riskut	Transferimi efektiv i riskut rrit efikasitetin dhe ul kostot për shtetin.
Kosto-Afatëgjatë	PPP-të në energji kanë kontrata afatgjata që ndikojnë buxhetin publik.	Analiza e kostove totale, auditime financiare, krahasim me prokurimin publik	Vlerësimi i plotë financiar duhet të bëhet para nënshkrimit të kontratës.
Performanca Teknike	PPP duhet të garantojë furnizim të qëndrueshëm dhe efikas të energjisë.	KPI për furnizim, ndërprerje, eficiencë teknike	Standardet teknike duhet të përfshihen në kontratë dhe të monitorohen rregullisht.

**TABELA PËR RASTIN E TRANSPORTIT NË SHQIPËRI**

<b>Aspekti</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Treguesit e Monitorimit</b>	<b>Mësimet e Nxjerra</b>
Përputhshmëria kontraktuale	PPP në transport urban duhet të lidhë pagesat me cilësinë e shërbimit.	Orari i mbërritjes së autobusëve, kënaqësia e udhëtarëve, penalitete për vonesa	Pagesat duhet të lidhen me performancën për të garantuar përmirësim të dukshëm.
Qëndrueshmëria mjedisore	Transporti publik duhet të kontribuojë në uljen e ndotjes dhe trafikut.	Emetimet CO <sub>2</sub> , përdorimi i mjeteve elektrike, raportet mjedisore	PPP duhet të përfshijë objektiva të qarta mjedisore dhe konsultim me komunitetin.
Transparenca financiare	Pagesat për operatorët duhet të jenë të qarta dhe të lidhura me performancën.	Raporte publike mbi pagesat, auditime të pavarura	Transparenca ndihmon në shmangien e abuzimeve dhe rrit besimin publik.

**TABELA PËR RASTIN E MJEDISIT NË SHQIPËRI**

<b>Aspekti</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Treguesit e Monitorimit</b>	<b>Mësimet e Nxjerra</b>
Ndikimi mjedisor	PPP në mjedis duhet të kontribuojë në mbrojtjen e biodiversitetit dhe klimës.	Raporte ndikimi, përqindja e mbetjeve të ricikluara, ndikimi në CO <sub>2</sub>	Nevojitet vlerësim i qartë i ndikimit mjedisor para nënshkrimit të kontratës.
Konsultimi publik	Projekte mjedisore shpesh përballen me kundërshtime nga komuniteti lokal.	Dokumentim i konsultimeve, pjesëmarrja e komunitetit	Përfshirja e komunitetit rrit legjitimitetin dhe shmang konfliktet sociale.
Qëndrueshmëria afatgjatë	PPP duhet të jetë në përputhje me SDG dhe të mos krijojë dëm afatgjatë.	Auditime vjetore, përputhje me SDG 11, 13, 16	PPP nuk është vetëm kontratë ekonomike, por edhe angazhim për zhvillim të qëndrueshëm.

**TABELA KRAHASUESE: SHEMBUJ SHQIPTARË VS NDËRKOMBËTARË**

<b>Fusha</b>	<b>Aspekti</b>	<b>Shqipëri</b>	<b>Ndërkombëtar</b>
Risia dhe Zhvillimi	Inovacion Teknologjik	PPP për laboratorët shëndetësorë – mungesë përmirësimesh të dukshme (BIRN, 2020)	MB – PPP në spitale solli teknologji të reja diagnostikuese dhe reduktim kohe pritjeje (Hellowell, 2018)
Përputhshmëria Kontraktuale	Lidhja e pagesave me performancën	Rruga e Arbrit – pagesat nuk lidhen me performancën, rritje kostosh	Kroaci – pagesat lidhen me mbërritjen në kohë të autobusëve, rrit besueshmërinë e shërbimit
Qëndrueshmëria Mjedisore dhe Sociale	Konsultimi Publik	Inceneratorët – mungesë transparence dhe konsultimi publik, mosbesim qytetar	PPP në Evropë – raste protestash për mungesë konsultimi (UNECE, 2019)
Menaxhimi i Riskut	Ndarja e Riskut	PPP shëndetësore – shteti merr riskun financiar, privati përfiton fitimet	Poloni – kontrata energjie ndan qartë riskun ndërtim/operim, ul barrën publike
Transparenca Financiare	Publikimi i kontratave dhe pagesave	2017–2024: 800 milionë € të paguara për 12 PPP, 6 nën hetim SPAK	Irlanda – të gjitha kontratat dhe pagesat janë publike online

**Referenca**

- ❖ World Bank. (2020). *Public-Private Partnerships Reference Guide Version 3*. Washington, DC: World Bank Group.
- ❖ OECD. (2012). *Principles for Public Governance of Public-Private Partnerships*. Paris: Organisation for Economic Co-operation and Development.
- ❖ European Investment Bank. (2015). *EPEC Guide to Public-Private Partnerships*. Luksemburg: European PPP Expertise Centre (EPEC).
- ❖ United Nations Economic Commission for Europe. (2019). *Guiding Principles on People-first Public-Private Partnerships in support of the United Nations Sustainable Development Goals*. Geneva: UNECE.
- ❖ International Monetary Fund. (2021). *Mastering the Risky Business of Public-Private Partnerships in Infrastructure*. IMF Departmental Paper No. 21/10.
- ❖ Ministria e Financave e Shqipërisë. (2023). *Raporti Vjetor mbi Performancën e Kontratave të Koncesionit dhe Partneritetit Publik Privat*. Tiranë: Ministria e Financave.